

Asylum Advice

Kërkesa për azil



Section 1: Kërkesa për azil

1.1 A ju duhet të aplikoni për azil?

Ju duhet të bëni kërkesë për azil (mbrojtje ndërkombëtare) vetëm nëse keni frikë të ktheheni në vendin tuaj. Që të pranoheni si një refugjat sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve, ju duhet të jeni larguar nga vendi juaj dhe të mos mundeni të ktheheni mbrapsht për shkak se keni një frikë të mirë-mbështetur nga persekutimi, bazuar në një nga arsyet në vijim:

- Racës tuaj
- Fesë tuaj
- Kombësisë tuaj
- Opinionit tuaj politik; ose
- Anëtarësisë tuaj në një grup të veçantë shoqëror.

Nëse vendoset se nuk jeni refugjat, për shkak se kërkesa juaj nuk është e bazuar në një nga pesë arsyet e renditura më lartë, por ka arsye të tjera që të besohet se ju do të përballeni me një rrezik të vërtetë lëndimi të rëndë nëse ktheheni në vendin tuaj, atëherë ju mund të kualifikoheni për mbrojtje humanitare.

Nëse nuk mendoni se keni një pretendim për mbrojtje ndërkombëtare (azil ose mbrojtje humanitare) por përsëri dëshironi të qëndroni në Mbretërinë e Bashkuar (MB) për arsye të tjera, ju duhet të kërkonti këshilla ligjore.

Nëse kërkesa juaj për mbrojtje ndërkombëtare refuzohet, ajo mund të ndikojë mbi çdo aplikim tjetër për leje që të vizitoni Mbretërinë e Bashkuar.

1.2 Ku mund të kërkoj azil?

A jeni në një aeroport, port detar ose stacion ndërkombëtar treni?

Nëse keni ndërmend të kërkonti azil, është e rëndësishme që ta bëni këtë sa më parë që të jetë e mundur kur hyni në Mbretërinë e Bashkuar. Nëse jeni larguar nga persekutimi dhe ju nevojitet mbrojtje atëherë duhet të kërkonti të flisni me një oficer të imigracionit. Kur të flisni me oficerin e imigracionit duhet të konfirmoni se po aplikoni për azil në Mbretërinë e Bashkuara për shkak se jeni në rrezik. Jeni tashmë në Mbretërinë e Bashkuar?

Nëse doni të kërkonti azil dhe jeni tashmë në Mbretërinë e Bashkuar, DUHET të caktoni një takim për t'u paraqitur tek Asylum Intake Unit në Londër (në jug-lindje të Londrës). Duhet të paraqiteni me gjithë personat që varen nga ju të cilët bëjnë pjesë në kërkesën tuaj për azil. Është e rëndësishme që kërkesën për azil ta bëni sa më parë që të jetë e mundur pasi të keni arritur në Mbretërinë e Bashkuar, ose menjëherë pasi të keni mësuar se rrethanat tuaja kanë ndryshuar dhe se tani ju duhet mbrojtje ndërkombëtare. Ju lutemi vini re se Home Office nuk do të paguaj për udhëtimin tuaj në Croydon.

Përveç sistemit të mësipërm të takimit, Asylum Intake Unit do të pranojë edhe aplikues që paraqiten aty personalisht. Megjithatë, nuk ka garanci që aplikimi juaj do të shqyrtohet të njëjtën ditë. Ju mund të këshilloheni të bëni një takim për një ditë tjetër për shqyrtimin e kërkesës tuaj.

Numri i telefonit për caktimin e takimeve me Asylum Intake Unit: 020 8196 4524
Orari i hapjes: E Hënë deri të Enjte, 9 paradite deri në 4.45 mbsadite dhe e Premte 9 paradite deri në 4.30 mbsadite.

Asylum Intake Unit ndodhet në Lunar House, 40 Wellesley Road, Croydon CR9 2BY.

Nëse ju duhet ta ndryshoni ose ta anuloni takimin tuaj, ju lutemi telefononi sa më parë që të jetë e mundur numrin 020 8196 4524.

Nëse ju jeni ne gjëndje të cënuar dhe ndodheni në Skoci mundet të lejoheni ta jepni intervistën fillestare në Glasgow. Megjithatë kjo është në dorë të Home Office dhe çdo çështje shqyrtohet në bazë të meritave.


1.3 Këshilla dhe udhëzime mbi kërkesën për azil dhe procesin e azilit

Asylum Help është pjesë e organizatës bamirëse Migrant Help. Nëpërmjet Asylum Help, organizata ofron këshilla dhe udhëzime për azilkërkuessit. Asylum Help mund t'ju ofrojë këshilla, udhëzime dhe informacion të pavarur FALAS mbi kërkesat për azil, procesin e azilit, strehimin, mbështetjen financiare, gjetjen e përfaqësuesit ligjor dhe çështje të tjera mbështetjeje të azilit.

Informacione mbi procesin e regjistrimit për azil, intervistës së zgjeruar dhe rreth asaj që ndodh pasi merret një vendim mbi çështjen tuaj, gjenden në format të shkruar dhe audio në faqen e internetit të ASYLUM ADVICE UK. Informacioni gjendet në 15 gjuhë kyçe. Ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit www.asylumhelpuk.org.

Nëse doni të flisni direkt me një këshilltar, ju lutemi telefononi FALAS Asylum Advice UK në numrin: 0808 8000 620. Ju lutemi vini re se Asylum Help nuk mund t'ju japë këshilla ligjore në lidhje me kërkesën tuaj për azil.

Diagrama e Procesit të Azilit



1.4 A ju nevojitet Mbështetje për Azilin?

Nëse ju duhet të aplikoni për mbështetje për azilin pasi kërkesa juaj të jetë regjistruar ose ju kanë lënë takim për të, atëherë duhet të telefononi linjen ndihmëse *FALAS:

Asylum Support Application UK në numrin 0808 8000 621

Ky shërbim mund t'ju ofrohet në një gjuhë që e kuptoni.

Informacione të mëtejshme në lidhje me mbështetjen për azil mund të gjenden në: www.asylumhelpuk.org

Nëse jeni i pastrehë ose nuk mund ta mbështesni veten, ju lutemi sigurohuni që ta bëni këtë gjë të qartë gjatë procesit të intervistës së regjistrimit për azil. Home Office do të vlerësojë nëse ju nevojitet strehim i përkohshëm, të cilin mund t'ju afrojnë menjëherë pas intervistës.

Nëse keni hyrë në Mbretërinë e Bashkuar me një vizë apo keni qenë të vetë mbështetur ju duhet të jepni një llogari të plotë se si e keni mbështetur veten dhe në çfarë i keni shpenzuar paratë. Ju do të duhet të tregoni përse kjo ndihme nuk egjistron më. Ju do të duhet të ofroni çdo dëshmi në lidhje me këtë në intervistën tuaj fillestare.

Nëse ju është refuzuar strehimi gjatë intervistës tuaj fillestare Asylum Help nuk do të jetë në gjendje t'ju ndihmojnë për të marrë strehim të menjëhershëm, por mund t'ju ndihmojë për të aplikuar për mbështetje afatgjatë.

1.5 Kthimi Vullnetar i Asistuar

Nëse vendosni se nuk doni të kërkonte azil dhe jeni një migrant i parregullt e dëshironi të ktheheni në atdhe, mund të jeni në gjendje të merrni ndihmë dhe mbështetje nga programi Kthimi Vullnetar i Asistuar i Home Office.

Për informacion të mëtejshëm ju lutemi vizitoni:

www.gov.uk/return-home-voluntarily

Departamenti i nisjes vullnetare: 0300 004 0202

Për informacion të mëtejshëm në lidhje me çdo pjesë të këtij seksioni, ju lutemi kontaktoni Asylum Help:

www.asylumhelpuk.org

Asylum Advice UK 0808 8000 620

Asylum Support Application UK 0808 8000 621